

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Këqyrja / *el-Muraakabeh* / المراقبة

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"لَا يَرْفُقُونَ فِي مَوْمِنٍ إِلَّا وَلَا ذِمَّةً"

"Kur kanë të bëjnë me besimtarët, ata nuk këqyrin as lidhjet familjare, as marrëveshjet për mbrojtje." (et-Teube, 10)

Muraakabe apo këqyrja nënkupton vëzhgim të vazhdueshëm të synimit përfundimtar. Kjo ndahet në tri nivele:

Niveli i parë është këqyrja e të Vërtetit (Allahut) duke ecur vazhdimisht drejt Tij midis:

- Madhërimit që heq vëmendjen¹
- Afërsisë që frymëzon²
- Gëzimit që përtërin³

Niveli i dytë është këqyrja e këqyrjes që ta bën Allahu, duke refuzuar të gjitha përzierjet (ndërhyrjet) nëpërmjet:

¹ Lavdërimi i Allahut i heq vëmendjen udhëtarit nga këqyrja e çdo gjëje tjetër (*el-ghajr*). Ky madhërim i të dashurit është i domosdoshëm për qëndrimin brenda kufijve të robërimit (ndaj të dashurit / Zotit). Ibn el-Kajjim tha se çdo dashuri pa madhërim, çon në mosrespektim, largim, dhe humbje të pozitës tek i dashuri.

² Sa më shumë t'i afrosh Atij, aq më shumë do të kesh energji për t'iu afruar më tej.

³ Gëzimi nga shërbimi (adhurimi) që ia bën Atij dhe ëmbëlsia e besimit që shijon i Zgjuari do ta përtërijë, do ta rigjallërojë, do ta ngushëllojë dhe do ta forcojë zemrën e tij gjatë gjithë këtij udhëtimi.

- Shmangies nga çdo formë e refuzimit⁴
- Dhënies fund të pakujdesisë së qëndrimit në mes (midis vetvetes dhe Atij)⁵

Niveli i tretë është këqyrja e përjetësisë së pafilluar duke drejtuar vëmendjen nga pararendja (e Allahu), ku ti:

- Qëndron karshi flamurit (idesë) së Teuhidit⁶
- Këqyr ndodhjen e manifestimit të *el-ezel* (përjetësisë së pafilluar) në *el-ebed* (përjetësinë e pafund)⁷
- Këqyr të shpëtosh nga gjendja e vështirë e këqyrjes⁸

⁴ Duke pranuar plotësisht urdhrat e Tij nëpërmjet nënshtrimit dhe duke pranuar caktimet e Tij nëpërmjet kënaqjes me to.

⁵ Kur je i vetëdijshëm për vetën tënde, për ndjenjat e tua, për mendimet e për aspiratat që ke, kjo pengon të parët e synimit përfundimtar dhe arritjes së tij.

⁶ Sepse kur ti kupton se Ai ka ekzistuar para ekzistencës i vetëm, atëherë të gjitha ekzistimet e varura nga Ai për krijimin dhe mbajtjen e tyre bëhen aq të parëndësishme në shikimin (*shuhûd*) tënd, saqë s'do ta pengojnë më të parët e tënd të flamurit të njësisë së Tij dhe as ecjen drejt realizimit të këtij njësimi (teuhidit).

⁷ Dija e Tij e para-përjetshme do të manifestohet përgjithmonë, kështu që, çfarëdo që ndodh, është ajo çfarë Ai ka ditur dhe ka caktuar në *el-ezel*. Ai është përtej kohës. Koha është krijesë e Tij.

⁸ Kurse këqyrja është e domosdoshme për të ardhur deri këtu, tash është koha të shpëtosh nga tërë ajo që i përket vetvetes (egos), përfshirë dhe aktin tënd të këqyrjes, në mënyrë që të mos jesh më i vetëdijshëm për gjë tjetër veç Tij. Ky është niveli përfundimtar i *fanaa* sipas Shejhul-Islam el-Harawi. Imam ibn el-Kajjim komenton se stacioni më i lartë është *fanaa* (asgjësimi i kufizuar) e vullnetit dhe e dëshirave tua, si dhe *fanaa* e çdo gjëje tjetër në vëmendjen apo të parët (*shuhûd*) tënd. Kjo ndodh atëherë kur vullneti yt të përputhet me të Tijin, derisa të shpërbëhet në të dhe ti të mos dëshirosh gjë tjetër veç asaj çfarë dëshiron Ai dhe të mos shohësh gjë tjetër veç Tij në veprimet e tua, sikur çdo gjë të zhdukej ashtu siç nuk ka ekzistuar në *el-Ezel* (përjetësinë e pafilluar), dhe të qëndrosh (*bekaa*) pranë Tij dhe për Të duke parë *xhem'* (njësinë e të Vërtetit, të Vetëmjaftueshmit) në *el-Ferk* (shumësinë e krijesave dhe të dukurive), duke u lutur për kujtimin e Tij, duke treguar mikpritje për mysafirin tënd, duke agjëruar, duke u ndihmuar nevojtarëve në kërkim të kënaqësisë së Tij, duke vdekur në rrugën e Tij, etj. Kjo është pika kur, ajo çfarë ti do nga Ai, shpërbëhet në atë çfarë Ai do nga ti.